



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Kruje me 03.09.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME
ME
OBJEKT

“MBIKQYRJA E PUNIMEVE PER OBJEKTIN “RIFORCIMI I NJËSISE SË BANIMIT NË NDËRTESEN QE I PERKET, PALLATIT 5.6 DHE 9 KT ME NR PASURIE 3/790, ZK.8621 ME VENDODHJE NE QYTETIN E KRUES RRUGA “DONIKA KASTRIOTI “),ME NDERHYRJE REHABILITUESE /PERSHTATESE TE DEMEVE TE SHKAKTUARA NGA TERMETI I DATES 26.11.2019 , NË BAZË TË AKTEKSPERTIZAVE TË THELLUARA”

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot me date **03.09.2026** ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit i ngritur me urdherin nr.461datë 03.09.2026 me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Kufizuar ne kuader te procesit te rindertimit”, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mbikqyrja e punimeve per objektin “Riforcimi i njësisë së banimit në ndërtesën që i perket, pallatit 5.6 dhe 9 KT me nr pasurie 3/790, ZK.8621 me vendodhje ne Qytetin e Krues rruga “Donika Kastrioti “),me nderhyrje rehabilituese /pershtatese te demeve te shkaktuara nga termeti i dates 26.11.2019 , në bazë të aktekspertizave të thelluara”.

LLOJI I PROCEDURES SE PROKURIMIT:PROCEDURE E KUFIZUAR NE KUADER TE PROCESIT TE RINDERTIMIT

- **Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati kohor për ekzekutimin:**
Kohëzgjatja e vlefshmerise së Marrëveshjes Kuadër do të jetë per nje afat maksimal prej 12(dymbedhjetë) muaj nga data e nenshkrimit te marreveshjes kuader .
- **Afati i kryerjes se sherbimit:** Nga data e lidhjes se kontrates se siper marrjes se zbatimit te punimeve deri ne perfundim te tyre [afati 12(dymbedhjetë) muaj]

Shenim-Ligji i aplikueshem ne kete procedure prokurimi eshte ligji nr. 162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’ i ndryshuar , akt normativ nr. 9, datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Mbikqyrja e punës se ndertimit /(71521000-6)

VLERA E FONDIT LIMIT : 1’625’197 (njemilion e gjashtëqind e njezet e pese mije e njeqind e nentedhjete e shtate) lekësh pa TVSH.

BURIMI I FINANCIMIT : Te ardhurat e Bashkise Kruje sipas planifikimit te buxhetit te miratuar me VKB nr.10 date 22.04.2026 “Per miratimin e buxhetit shtese te vitit 2026 ” dhe **VKB nr.44 date 21.07.2026 ‘Per perdorimin e fondeve te rindertimit’.**

Procedura e prokurimit do të jetë “**E Kufizuar**”, e llojit **Marrëveshje Kuadër - me disa operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 (njezet e kater) muaj** mbështetur në nenin 52 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe sipas nenin 60, pika 1/c, nenit 61 pika 1, neni 62, neni 63, neni 64 pika 1/b.ii , neni 65, neni 66 të kreu VII, e VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ”, i ndryshuar , Në bazë të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 42; të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Neni 21, pika 2; si dhe të të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Neni 2, pika 2/c si dhe Neni 78, pika 2, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;(Do te paraqitet FAZEN e II-te)

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;

c. Sigurim oferte,sipas Shtojcës 5(Do te paraqitet FAZEN e II-te)

ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 10;

e. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.

ë.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti përgjegjës),

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

a) Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 09.

b) **Operatorët ekonomik duhet të paraqesin** vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2026 të lëshuar nga ana e njesive vendore ku operatori ekonomik ka selinë si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së takses vendore 2026 për secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”. Gjithashtu referuar faktit se procedura i përket procesit të rindertimit, argumentimi i kërkesave e kriterëve si me sipër rezulton të jenë bazuar plotësisht në parashikimet Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 42 si dhe referuar Dokumentave Standarte të Tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit e përshpejtuar për kontratat e punës.

2.4-Licensa e shoqërisë/ofertuesit:

a) Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit, për këtë arsye duhet të paraqesi licensën perkatese të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit të miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

-**NP-1**→Punime gërmimi në tokë.

-**NP-3**→Rikonstruktion e mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje

fasada.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

-NS-4→Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

-NS-9→Punime strukturore speciale.

-NS-14→Impiante të brendshme elektrike, telefonike dhe telekomunikacioni.

-NS-18→Punime topogjeodezike.

Shenim –Licensa duhet te jete leshuar sipas rregullave te VKM nr.759 date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (Ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016)

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr.759 date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kategorite e kerkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve qe do realizohen sipas preventivit dhe projektit te zbatimit.

*Kerkesa e disponimit te nje license te tille te leshuar nga ana e organeve kompetente eshte e lidhur ngushtesisht me tipologjin e sherbimit te kerkuar objekt kontrate si dhe elementeve te zerave te preventivit , ku jane zera te cilet jane te pasqyruar ne **VKM nr.216 DT 13..04.2023**”*

Sistemi i Integruar i Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim”.

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi teknik:

-NP-1→ Punime gërmimi në tokë. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve të gërmimit, sipas zërit nr.2.1, 2.3, 2.4, 2.5, 17.1, 17.2, 18.1, 18.2 të preventivit.

-NP-3→ Rikonstruksion e mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve të rikonstruksionit, sipas zërit nr.1.1÷1.17, 4.1, 4.3, 5.1÷5.7, 6.1, 6.2, 6.6, 10.1,

10.2, 10.3, 10.5, 10.6, 10.7, 10.8, 10.8*, 17.3÷17.19, 18.3÷18.11, 19.1÷19.4, 20.1÷20.7 (20.8*) të preventivit.

-NS-4→ Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve të rifiniturës, sipas zërit nr.7.1÷7.7, 8.1, 8.3, 9.1, 10.22 të preventivit.

-NS-9→ Punime strukturore speciale. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve strukturore speciale, sipas zërit nr.10.9, 10.10, 10.11, 10.12, 10.16, 10.17, 10.18, 10.19, 10.21, 10.23 të preventivit.

-NS-14→ Impiante të brendshme elektrike, telefonike dhe telekomunikacioni. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve elektrike, sipas zërit nr.11.1÷11.7, 12.1÷12.6, 13.6÷13.21, 14.1÷14.13, 15.1*÷15.3*, 16.1*÷15.7*, të preventivit.

-NS-18→ Punime topogjeodezike. Kjo pikë kategorie është vendosur për mbikëqyrjen e punimeve topogjeodezike, sipas zërit nr.2.3, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6, 6.1, 6.2, 6.6, 7.7, 10.2, 10.4, 10.9, 10.11, 10.17, 10.18, 10.19, 10.21, 18.1, 18.2, 18.3, 18.4, 18.5, 18.6, 18.7, 18.8, 18.9, 18.10, 18.11 të punimeve të preventivit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterave ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a)-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2023,2024,2025) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates, qe prokurohet përkatësisht: 650'078(gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e tete) lekë pa TVSH.

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit

publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar nën 77 të LPP, si edhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 5 dhe 6, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në vlerën e marre reference për kufirin e raportit të % se kufiri të xhiros për të konsideruar të plotësuar kriterin e mesipër, argumentojmë se ky raport që përben kufirin maksimal të përcaktuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i atribuohet faktit se duke marrë në analizë vlerën e fondit limit është me se mundur që ky kufi iu jep mundësi të gjithë subjekteve ekonomike të çdo lloji kapaciteti financiar (të mesëm dhe të vegjël), të kenë mundësinë e ofertimit pasi është marzhi tejet i aksesueshëm

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me një vlerë sa 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht në shumën **325'039 (treqind e njëzet e pesë mijë e tridhjetë e nente) lekë pa TVSH.**

Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.5-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik:

2.5.1-Per realizimin me sukses të kësaj kontrate kërkohet stafi i mëposhtem teknik i cili duhet të vihet në dispozicion nga ana e Operatorit Ekonomik Ofertues si vijon.

a)Ing.Ndertimi-1 (nje) –Per të konfirmuar këtë kusht kërkohet të paraqitet kontrata e vlefshme e punës, pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës, diploma e tij dhe librezë e punës .

a)Ing.Elektrik- 1 (nje) –Per të konfirmuar këtë kusht kërkohet të paraqitet kontrata e vlefshme e punës, pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës, diploma e tij dhe librezë e punës .

a)Ing.Gjeodet/Topograf- 1 (nje) –Per të konfirmuar këtë kusht kërkohet të paraqitet kontrata e vlefshme e punës, pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës, diploma e tij dhe librezë e punës

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c” dhe në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 “Për perballimin e fatkeqesive natyrore”, Neni 42.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Preventivin e Punimeve si dhe Grafikon sipas

koheshtrirjes se zbatimit te objekteve , Specifikimet Teknike rezulton se është e domosdoshme që Ofertuesi të ketë pjesë të **stafit inxhinieret si vijon:**

-Argumentimi teknik:

• **Inxhinier Ndertimi**

1

Është kërkuar për mbikëqyrjen e punimeve ndërtimore sipas pikës NP-1 (punime gërmimi në rrugë), NP-3 (rikonstruksion godinash civile e industriale), NS-9 (punime strukturore speciale).

• **Inxhinier Gjedodet/Topograf**

1

Është kërkuar për mbikëqyrjen e punimeve topogjeodezike sipas pikës NS-18 (punime topogjeodezike).

• **Inxhinier Elektrik**

1

Është kërkuar për mbikëqyrjen e punimeve elektrike sipas pikës NS-14 (punime të brendshme elektrike).

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.6-a) Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", si dhe në mbështetje të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot "Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016" "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" si dhe Rekomandimit te dates 27.06.2018 me nr 6559 prot te APP.

b) Shenim- Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" .

- Fondi limit i preventivit te zbatimit te objektit "Riforcimi i njësise së banimit në ndërtesen qe i perket, pallatit 5.6 dhe 9 KT me nr pasurie 3/790, ZK.8621 me vendodhje ne Qytetin e Krujes rruga "Donika Kastrioti "), me nderhyrje rehabilituese /pershtatese te demeve te shkaktuara nga termeti i dates 26.11.2019 , në bazë të aktekspertizave të thelluara", eshte ne vleren prej, 163'730'022(njeqind e gjashtedhjetë e tre milion e shtateqind e tridhjetë mije e njezet e dy) lekë pa t.v.sh .

Argumentimi- Nje kerkese e tille sa i perket kufirit minimal te vleres se oferten ekonomike – financiare te sherbimit te mbikqyrjes eshte e justifikuar sipas normave te legjislacionit ne fuqi

per standartizimin e kosos se ofrimit te sherbimit profesional te mbikqyrjes/kolaudimit , konkretisht referuar VKM nr nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” .

Gjithashtu nga ana e Njesise se Prokurimit eshte marre ne konsiderate edhe **Rekomandimi i APP me Nr. 5585 Prot 25.07.2017**, ”Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike/termave te references

- Termat e References per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Kontrollit dhe Planifikimit te Territorit te Bashkise Kruje sipas te dhenave te shkreses me **nr.7147 prot datë 03.09.2026**. .Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit , konkretisht Ligjit nr.107/2014 ‘Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’, normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e Ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar,udhezimit nr 3 date 15.02.2001 i KM ‘Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te zbatimit ne ndertim” i ndryshuar
- Termat e References per sherbimin e mbikqyrjes , jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.
- **Fondi Limit i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te V.K.M nr.354 date 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.**, dhe jane marre ne konsiderate te tere elementet perberes te sherbimeve te domosdoshme per ekzekutimin e kontrates.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK